



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**Kuvendi**

**PROJEKTLIGJ**

Nr. \_\_\_\_\_/2023

**PËR**

**DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 7703, DATË 11.05.1993 “PËR SIGURIMET SHOQËRORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, të Kushtetutës, propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë,

**VENDOSI**

Në Ligjin Nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen shtesa dhe ndryshime si më poshtë:

**Neni 1**

Në nenin 10, “Masa e kontributeve”, bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Pas fjalisë së tretë shtohet fjalia me përmbajtje si më poshtë:

“Pas datës 01.04.2023 paga maksimale për efekt kontributi rritet me të njëjtën masë dhe në të njëjtën kohë me masën që rritet paga minimale në shkallë vendi.”

2. Në fund të nenit 10 shtohet paragrafi me përmbajtje si më poshtë:

“Personat e punësuar me profesion në fushën e teknologjisë së informacionit (IT), dhe të regjistruar në subjektet me aktivitet kryesor në fushën e teknologjisë së informacionit të cilët ushtrojnë aktivitetin e tyre sipas Ligjit Nr. 58/2022 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Parqeve Teknologjike dhe Shkencore”, të miratuara sipas legjislacionit në fuqi, për këtë kategori paguajnë kontributet e sigurimeve shoqërore në nivelin e pagës minimale mujore në shkallë vendi, me miratimin paraprak të punëmarrësit, të evidentuar në kontratën e punës, pavarësisht pagës bruto të deklaruar.

**Neni 2**

Pas nenit 15, “Pagesa e kontributeve”, shtohet neni 15/1 me përmbajtje si më poshtë:

“Neni 15/1

“Përfshihen nga detyrimi për të paguar kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore, përfituesit e pensionit të pleqërisë që vetëpunësohen si të vetëm në sektorin privat.”

### **Neni 3**

Në nenin 57, “Tërheqja e kësteve të përfitimit”, pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

“5. Paguesa nuk ndalohej nëse përfituesi i pensionit të pleqërisë punon në sektorin privat si punësuar apo i vetëpunësuar.”

### **Neni 4**

Pas nenit 58, “Periudhat e sigurimit” shtohet neni 58/1, me përmbajtje si më poshtë:

“Neni 58/1

Përfituesit e pensionit të pleqërisë, të cilët ndërkohë që tërheqin këstin mujor të pensionit, janë të punësuar ose të vetëpunësuar në sektorin privat, nuk i njihet periudha e punësimit si periudhë sigurimi për efekte përfitimi nga ky ligj.”

### **Neni 5**

Neni 72, “Përbërja dhe Emërimi i Këshillit Administrativ” ndryshohet, si më poshtë:

“1. Këshilli Administrativ i Institutit të Sigurimeve Shoqërore përbëhet nga 12 anëtarë nga të cilët:

- a) Këshilli i Ministrave përfaqësohet me 6 anëtarë si më poshtë:
  - i. Përfaqësuesi i ministrisë përgjegjëse për çështjet e sigurimeve shoqërore,
  - ii. Zëvendësministri që mbulon marrëdhëniet e punës dhe çështjet e sigurimeve shoqërore ose çështjet financiare,
  - iii. Përfaqësuesi i agjencisë së ngarkuar për mbledhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore,
  - iv. Përfaqësuesi i Ministrisë së Drejtësisë,
  - v. Përfaqësuesi i institucionit që mbulon çështjet e sigurimit të kujdesit shëndetësor,
  - vi. Përfaqësuesi i Institutit të Statistikave.

Përfaqësuesit sipas ministrive apo institucioneve janë titullarët ose persona të deleguar prej tyre. Në çdo rast një nga gjashtë përfaqësuesit e shkronjës "a" do të jetë nga ministria për çështjet financiare.

- b) 3 anëtarë caktohen nga organizatat më të përfaqësuara të punëdhënësve, të cilat për zgjidhen me vendim të Këshillit të Ministrave.
- c) 3 anëtarë caktohen nga sindikatat më të përfaqësuara, të cilat për zgjidhen me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Emërimi i anëtarëve të përcaktuar në shkronjat "b" dhe "c" është i vlefshëm për një periudhë jo më shumë se 5 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë.

3. Shkarkimi i anëtarëve mund të bëhet në çdo kohë nga autoriteti që i emëron.”

### **Neni 6**

Në nenin 75, “Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorit të Përgjithshëm”, shkronja "d" riformulohet me këtë përmbajtje:

“d) Emëron punonjësit e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, si dhe përcakton rregullat rekrutimit të personelit. Procedurat përcaktohen në rregulloren e personelit, e miratuar me vendim të Këshillit Administrativ.”

## **Neni 7**

Në nenin 84, “Kërkesa”, pika "2" riformulohet me këtë përmbajtje:

“Kërkesat, së bashku me dokumentat e përcaktuara në rregulloren e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, paraqiten në portalin qeveritar e-albania ndërsa dokumentat origjinalë ose të njehsuar dërgohen me postë.”

## **Neni 8**

Në nenin 85, “Përlllogaritjet”, pika "3" riformulohet me këtë përmbajtje:

“3. Pensionet caktohen nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore nëpërmjet zyrave rajonale ose një strukture të posaçme të ngritur për këtë qëllim, brenda ditës së fundit të muajit të ardhshëm nga data e pranimit të kërkesës dhe dokumentave të plota të sakta për pension.”

## **Neni 9**

Në fund të nenit 87, “Pagesat”, shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Instituti i Sigurimeve Shoqërore dërgon zyrtarisht në bankë vendimin për bllokimin e llogarisë bankare të pensionistit dhe kthimin në llogarinë e fondit të sigurimeve shoqërore të kësteve të pensionit që u përkasin periudhave pasi pensionisti ka ndërruar jetë dhe që i janë kredituar padrejtësisht në llogari, për shkak të mos çregjistrimit nga regjistri i Gjendjes Civile. Vendimi që evidenton shumat e kësteve të pensionit të kredituara padrejtësisht, të bllokuara nga banka, përbën titull ekzekutiv dhe ekzekutohet nga banka.”

## **Neni 10**

Ky ligj hyn 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe shtrin efektet nga kjo ditë.

**KRYETARI**

**LINDITA NIKOLLA**